



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 9/2022 (JR)  
Nr. 9/3 regj.

Tiranë, më 26.05.2022

**SHPALLJE**  
**E**  
**NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË SEANCË PUBLIKE**

Nëpërmjet kësaj shpalljeje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet pjesëmarrëse në proces, si dhe të gjithë personat e interesuar se **ditën e hënë, në datën 04.07.2022, ora 10:00**, do të shqyrtohet në seancë gjyqësore publike çështja e Juridiksionit të Rivlerësimit, me numër regjistri (JR) 9/2022, datë 15.02.2022 për ankimin e Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 491, datë 21.12.2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Gjon Kodra.

Seanca gjyqësore publike do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, Tiranë.


Trupi Gjyqësor përbëhet nga gjyqtarët:

**Kryesuese e Trupit Gjyqësor**  
**Relatore e Çështjes**  
**Gjyqtare**  
**Gjyqtare**  
**Gjyqtar**

**Albana Shtylla**  
**Natasha Mulaj**  
**Mimoza Tasi**  
**Rezarta Schuetz**  
**Sokol Çomo**

Bazuar në nenin 460, pika 5 e Kodit të Procedurës Civile, kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë para seancës së gjyqimit, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe në ambientet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe në faqen e internetit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe me njoftim individual në të dhënat e kontaktit të subjektit të rivlerësimit të deklaruara në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, si dhe të dhënat elektronike të Institucionit të Komisionerëve Publik.

**KRYESUESE E TRUPIT GJYKËS**  
**GJYQTARE**

  
**ALBANA SHTYLLA**

